

## Përmbajtja:

### 1: Hyrje

2: Veprimtari kryesore

3: Formimi Fillestar

4: Formimi Vazhdues

5: Agjenda e muajit Maj

6. Sektori i studimeve dhe publikimeve

## Të nderuar,

Ju prezantojmë me numrin e katërt të **Buletinit Informativ të Shkollës së Magjistraturës**, mbi veprimtarinë e saj akademike dhe administrative gjatë muajit prill.

## Formimi Fillestar

### Zemra e magjistratëve të rinj

## Konkursi i pranimit 2026-2027

Muaji prill shënon zhvillimin e provimit të pranimit për kandidatët për magjistratë dhe avokat shteti. Ky provim u zhvillua në tre ditë, përkatësisht në datën 21, 23 dhe 24 prill 2026. Në datën 21 prill u zhvillua faza e parë me natyrë skualifikuese, ku kandidatët iu nënshkruan testit me alternativa, i cili u korigjua me anë të pajisjes scan tron. Në datën 23 dhe 24 prill u zhvillua faza e dytë, testi profesional, ku konkurrentët iu përgjigjën me shkrim pyetjeve mbi konceptet, pyetjeve krahasuese, pyetjeve argumentuese dhe atyre analitike, si dhe i dhanë zgjidhje një kazusi penal, civil dhe administrativ.



"Në datën 14 prill 2026 u zhvillua trajnimi në lidhje me strukturën dhe mënyrën e organizimit të provimit, duke përfshirë udhëzime praktike për përgatitje, llojet e pyetjeve, kohëzgjatjen e provimit, menaxhimin e kohës dhe stresit, si dhe mënyrën e vlerësimit. U trajtuan gjithashtu rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur gjatë zhvillimit të provimit me qëllim garantimin e një procesi të rregullt dhe transparent. Një pjesë e rëndësishme e trajnimit lidhej me etikën dhe integritetin akademik, duke theksuar parandalimin e shkeljeve dhe ruajtjen e konfidencialitetit".

## Aktivitetet e muajit

- Zhvillimi i procesit mësimor nga e hëna në të premte, nga ora 8:30 deri në orën 16:50.
- Zhvillimi i vlerësimit të tretë në lëndën e gjykimit kushtetues, si dhe vlerësimit përfundimtar në lëndën e gjykimit civil, gjykimit administrativ dhe hetimit e gjykimit penal.
- Klinika ligjore
- Zhvillimi i praktikës paraprofesionale nga kandidatët për magjistratë të vitit të dytë.
- Zhvillimi i gjyqeve imituese nga kandidatët e vitit të dytë.
- Zhvillimi i praktikës profesionale nga kandidatët e vitit të tretë në gjykata dhe prokurori.

- Bashkëbisedim mbi jurisprudencën e GJEDNJ-së.

## Viti i parë

Gjatë muajit prill krahas mësimit në auditor u zhvilluan edhe katër vlerësime të programuara në lëndën e gjyqimit kushtetues, gjyqimit civil, gjyqimit administrativ dhe hetimit e gjyqimit penal.



Çaste nga vlerësimet përfundimtare prill 2026

*“Çdo provim është një betejë e vogël drejt fitores së madhe.”*

## Viti i dytë

Kandidatët për magjistratë të vitit të dytë, në përmbushje të programit mësimor të formimit fillestar zhvilluan një vizitë studimore në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut, 1 – 2 prill 2026. Ata ishin të pranishëm në zhvillimin e seancës gjyqësore të Dhomës së Madhe të Gjykatës, në çështjen S.O kundër Spanjës (nr. 5742/22), si dhe u takuan me juristë të gjykatës me të cilët diskutuan për çështje me rëndësi ndërkombëtare, si mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e mjedisit. Kandidatët për magjistratë u njohën më nga afër edhe me Njësinë Shqiptare të Sekretariatit të Gjykatës, të cilët shpjeguan metodologjinë e punës në Gjykatë dhe çështjet shqiptare që janë gjykuar deri më tani. Në përmbyllje

të vizitës studimore, kandidatët takuan edhe gjyqtarin shqiptar, z. Darian Pavli.



*“Vizitat studimore e shndërrojnë teorinë në përvojë dhe e afërsojnë kandidatin me realitetin e drejtësisë.”*

## Zhvillimi i gjyqeve imituese

Nga data 30 mars deri në datën 3 prill 2026 kandidatët zhvilluan gjyqin e pestë imitues, nën drejtimin e pedagogëve dhe gjyqtarëve më me emër në fushën penale dhe civile.

## Leksion i hapur mbi jurisprudencën e GJEDNJ-së

Në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Evropës “Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit shqiptar për të zbatuar më mirë standardet mbi të drejtën e lirisë dhe sigurisë” u zhvillua një leksion i hapur me kandidatët për magjistratë të vitit të dytë mbi njohjen me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi të drejtën e lirisë dhe sigurisë.

Kandidatët ndanë shembuj nga përvojat e tyre dhe shprehën interes rreth standardeve të vendosura nga Këshilli i Evropës mbi paraburgimin, masat parandaluese dhe heqjen e lirisë.

Në datën 24 dhe 27 prill, kandidatët për magjistratë, profili gjyqtar dorëzuan dosjet administrative, ndërsa kandidatët për prokurorë dorëzuan dosjen penale nr.3, pas praktikës në gjykatën administrative dhe në gjykatën e shkallës së Parë, Dhoma Penale.

## Viti i tretë

Kandidatët e vitit të tretë vijojnë praktikën profesionale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku angazhohen konkretisht në dhomat civile dhe penale, si dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Përmes kësaj praktike, kandidatët njihen nga afër me funksionimin e përditshëm të institucioneve të drejtësisë, procedurat gjyqësore dhe prokuroriale, si dhe me rolin dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm në procesin e administrimit të drejtësisë. Kjo përvojë praktike shërben si një hallkë thelbësore në formimin e tyre profesional, duke forcuar aftësitë analitike, njohuritë praktike dhe përgatitjen për ushtrimin e ardhshëm të detyrës si magjistratë.

*“Pa drejtësi nuk ka paqe, as besim.”*



## Orari për muajin maj

MUAJI MAJ												
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel
Java 30	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	2	3
8:30 - 11:20												
12:00 - 14:50												
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel
Java 30	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	9	10
8:30 - 11:20	AFAM6	MGID8	Mjedis6	Puna6	Puna6	AFAM6	MGID8	Mjedis6	Familjaria	FUND		
12:00 - 14:50									GJK	FUND		
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel
Java 31	11		12		13		14		15		16	17
8:30 - 11:20	Kontrat6	MGID4	Mjedis7	Puna8	Puna8	AFTM6	MGID4	Mjedis7	AFTM6	Kontrat6		
12:00 - 14:50		ASHL4					ASHL4					
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel
Java 32	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	23	24
8:30 - 11:20	Kontrat6	MGID4	Mjedis7	Puna	Puna	AFM8	MGID4	Mjedis7	AFM	Kontrat6		
12:00 - 14:50		ASHL					ASHL					
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel
Java 33	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	30	31
8:30 - 11:20	Kontrat7	MGID6	Vlerësim				MGID6	Mjedis4	Mjedis4	Kontrat7		
12:00 - 14:50			AFM					Puna3	Puna3			

## Mbledhja e Asamblesë së Kandidatëve për Magjistratë

Më datë 16.4.2026 u organizua mbledhja dhe votimi për përzgjedhjen e kryetarit të Asamblesë së Kandidatëve dhe Anëtarit të Komisionit Disiplinor nga radhët e kandidatëve për magjistratë. Në përfundim të procesit të numërimit të votave, kandidatët fitues ishin: Kleada Mersinllari – Kryetar i Asamblesë së Kandidatëve

dhe Ardit Kola – Anëtar i Komisionit Disiplinor të Shkollës së Magjistraturës.



## PROVIMI I PRANIMIT PËR NDIHMËS LIGJOR

Provimi i pranimit për ndihmës ligjor do të organizohet në datën 19 maj 2026 në mjediset e Hotel Tirana, salla “Akernia”, ora 8.00.

Provimi është me shkrim në një ditë, i ndarë në dy pjesë, ndërmjet të cilave do të ketë një pushim 45 minutësh.

Kohëzgjatja e provimit është 5 orë.

Totali i pikëve 100 pikë

**PJESA E PARË: (2 orë)**

Rubrika I: Pyetje me alternativa (20-30 pikë)

Rubrika II: Pyetje mbi koncepte, pyetje krahasimore ose pyetje argumentuese (10-20 pikë)

**PJESA E DYTË: (3 orë)**

Rubrika III: Opinione ligjore (60 pikë)

## Formimi i trajnimit vazhdues

Gjatë muajit prill 2026, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi 21 aktivitete trajnuese në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe subjekteve të tjera ligjore nga të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë. Aktivitetet u fokusuan në forcimin e kapaciteteve profesionale, unifikimin e praktikës gjyqësore dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare.

Këto trajnime u ndoqën në total nga 541 pjesëmarrës (numër total pjesëmarrjesh).

Aktivitetet trajnuese të muajit prill 2026 u zhvilluan në kuadër të moduleve:

- **Ekzekutimi i detyrueshëm** – [grupi i synuar, përmbaues gjyqësorë]
- **Media** – [grupi i synuar, gjyqtarë, prokurorë]
- **Provat dhe mjetet e kërkimit të provës në procesin penal**– [grupi i synuar, gjyqtarë penalistë, prokurorë, hetues, opgj]
- **Diskriminimi** – [grupi i synuar, gjyqtarë, prokurorë]
- **Gjykimi në seancë paraprake** - [grupi i synuar, gjyqtarë, prokurorë]
- **Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë** – [grupi i synuar, gjyqtarë penalistë, prokurorë, hetues, opgj]
- **Kontrolli i akteve të organeve të shoqërisë tregtare. Natyra e vendimmarrjes së gjykatë** – [grupi i synuar, gjyqtarë, avokatë shteti]
- **Trajnime të posaçme 1 ditore si “Likuidimi i shoqërive tregtare në gjendje të aftësisë paguese”.**

Moduli “**Ekzekutimi i detyrueshëm**” u zhvillua me një pjesëmarrje të gjerë dhe interes të veçantë nga përmbauesit gjyqësorë, në datat 1, 2 dhe 7 prill 2026. Gjatë aktiviteteve trajnuese u trajtuan çështje praktike që lidhen me procedurat e ekzekutimit, sfidat në zbatim dhe praktikat më të mira për rritjen e efikasitetit në këtë fazë të rëndësishme të procesit gjyqësor. Diskutimet

interaktive dhe shkëmbimi i përvojave kontribuan në thellimin e njohurive profesionale dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të përfshirë, duke e bërë këtë modul një nga aktivitetet më të vlerësuara nga pjesëmarrësit.



Foto 1. Aktivitet trajnues, datë 1 prill 2026

Foto 2. Aktivitet trajnues, datë 1 prill 2026

Moduli mbi median, me temë **“Siguria e gazetarëve dhe mbrojtja e lirisë së shprehjes”**, u zhvillua ekskluzivisht për gjyqtarë dhe prokurorë, duke shënuar një pjesëmarrje të konsiderueshme dhe interes të lartë. Gjatë aktivitetit u trajtuan standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e gazetarëve, sfidat që lidhen me sigurinë e tyre në ushtrimin e profesionit, si dhe roli i gjyqtarëve dhe prokurorëve në garantimin e lirisë së shprehjes. Diskutimet u përqendruan gjithashtu në balancimin ndërmjet kësaj lirie dhe kufizimeve të

ligjshme, duke nxitur një shkëmbim të vlefshëm përvojash dhe praktikash profesionale.




Foto 3. Trajnim i datës 15 prill 2026.

Foto 4 Trajnim i datës 16 prill 2026.

Moduli **“Provat dhe mjetet e kërkimit të provës në procesin penal”** dhe moduli **“Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë”** u zhvilluan në kuadër të trajnimeve në fushën penale, me pjesëmarrje aktive dhe interes të lartë nga gjyqtarë dhe prokurorë. Moduli i parë trajtoi çështje që lidhen me sigurimin, administrimin dhe vlerësimin e provave, me fokus të veçantë te provat digjitale dhe garancitë procedurale për respektimin e të drejtave themelore. Ndërsa moduli i dytë u përqendrua në bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale, duke adresuar aspektet praktike të ndihmës juridike të ndërsjellë, mekanizmat e përbashkët hetimorë dhe zbatimin e kuadrit ligjor

përkatës. Të dy modulet u karakterizuan nga diskutime interaktive dhe shkëmbim përvojash, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve profesionale të pjesëmarrësve.

Moduli “**Diskriminimi**” u zhvillua me pjesëmarrje aktive nga gjyqtarë dhe prokurorë, duke trajtuar dy tema kryesore: “*Ndalimi i diskriminimit në ligjin ndërkombëtar, evropian dhe shqiptar*”, me fokus në standardet e mosdiskriminimit, barrën e provës, marzhet e vlerësimit gjyqësor, arsyetimin e vendimeve dhe të drejtën e ankimit; si dhe “*Perspektiva gjinore dhe diskriminimi*”, me trajtim të çështjeve të shpërblimit të dëmit në rastet e diskriminimit. Këto trajnime u karakterizuan nga diskutime të thelluara dhe shkëmbim përvojash profesionale, duke forcuar njohuritë praktike në këtë fushë.




Foto 5. Trajnim i datës 9 prill 2026

Foto 6. Trajnim i datës 23 prill 2026

Moduli “**Kontrolli i akteve të organeve të shoqërisë tregtare. Natyra e vendimmarrjes së gjykatës**” u zhvillua me pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe avokatëve të shtetit, duke shënuar interes të lartë në trajtimin e çështjeve të së drejtës tregtare. Gjatë trajnimit u analizuan standardet dhe kufijtë e kontrollit gjyqësor mbi aktet e organeve të shoqërive tregtare, si dhe natyra e vendimmarrjes gjyqësore në këto raste, me fokus në balancimin ndërmjet autonomisë së shoqërive dhe garantimit të ligjshmërisë. Moduli u karakterizua nga diskutime praktike dhe shkëmbim përvojash profesionale ndërmjet pjesëmarrësve.



Foto 7. Trajnim i datës 29 prill 2026.

Foto 8. Trajnim i datës 30 prill 2026.

Muaji prill u karakterizua nga një gamë e gjerë aktiviteteve trajnuese me fokus në fusha të ndryshme të së drejtës penale, civile dhe tregtare, si dhe në tema me

rëndësi të veçantë si diskriminimi, media dhe bashkëpunimi juridiksional ndërkombëtar. Trajnimet u zhvilluan me pjesëmarrje aktive të gjyqtarëve, prokurorëve, përmbauesve gjyqësorë dhe avokatëve të shtetit, duke nxitur diskutime të thelluara dhe shkëmbim të vyer përvojash profesionale.

Temat e trajtuara reflektojnë sfidat aktuale të praktikës gjyqësore dhe nevojën për forcimin e standardeve profesionale, në përputhje me zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në tërësi, aktivitetet e muajit prill kontribuan në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe në konsolidimin e praktikave bashkëkohore në sistemin e drejtësisë.

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Akademisë së Drejtësisë së Kosovës dhe Shkollës së Magjistraturës, në datën 7 prill 2026, në ambientet e Shkollës, u realizua aktiviteti trajnues me tematikë *“Format e ndikimit të medias te sistemi i drejtësisë dhe komunikimi në kohë “krize”. Situatat që kapin në befasi sistemin e drejtësisë, menaxhimi i tyre për të mos lejuar dëmtimin e imazhit të strukturave të drejtësisë në sytë e publikut”* me pjesëmarrjen e magjistratëve nga Kosova dhe magjistratëve nga Shqipëria.

Në aktivitetin lançues përshëndetën Drejtori i Shkollës, Z. Arben Rakipi dhe Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, Z. Enver Fejzullahu.

Në aktivitetin trajnues u trajtuan temat subjekt i seminarit të angazhuar nga Shkolla dhe Akademia e Kosovës si format e ndikimit të medias te sistemi i drejtësisë dhe menaxhimi i tentativës për ndikim, dhe sjellja e magjistratit ndaj këtyre formave publike. Tematikat u shoqëruan me raste të praktikës gjyqësore nga Shqipëria dhe Kosova.



## Metodologjia e aktiviteteve trajnuese


Trajnimet u realizuan duke ndërthurur prezantimet (deri në 20-30 min) me diskutimin e çështjeve të shtruara (pyetjeve vetë studimore; pyetje-përgjigje) dhe ushtrimeve me raste praktike & kuize, për të nxitur dhe realizuar ndërveprimin aktiv të pjesëmarrësve.

Për muajin **maj** janë planifikuar: **20 trajnime të formimit vazhdues.**

## Spektori i Studimeve dhe Publikimeve

*“Përmes botimeve juridike, doktrina jo vetëm interpreton ligjin, por kontribuon në evolimin e tij”*

Gjatë muajit prill 2026 doli revista shkencore juridike, botim i shkollës së magjistraturës Nr.2, viti 2024,



e cila në përmbajtjen e saj ka:

- Rubrika 1 - Artikuj teorikë.
  - **Prof. dr. Aurela Anastasi** - Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës dhe zbatimi i konventave të Hagës në Gjykimin Kushtetues.
  - **Arben Isaraj** - Polifonia labe: etika e bashkëjetesës dhe harmonisë kolektive
- Rubrika 2 – Opinione dhe debat juridik.
  - **Dr. Altin Shkurti & Aulona Hazbiu** - Titujt Ekzekutiv
- Rubrika 3 – Njohje me legjislacionin e ri.
  - **Ylli Pjetërnikaj** - Efektiviteti i sistemit të drejtësisë nëpërmjet inteligjencës artificiale. Kuadri Ligjor, jurisprudencë dhe praktikë krahasuese-Implikime juridike, etike dhe praktike për gjyqtarë dhe prokurorë.
- Rubrika 4 – Njohje me praktikën gjyqësore.
  - **Prof. assoc. dr. Petrina Broka** - Sigurimi i padisë në procesin gjyqësor civil dhe administrativ
  - **Gentian Hamiti** - Parashkrimi i disa prej padive, në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative
  - **Av. Arben A. HAKANI** - Kufizimet e testamentit sipas neneve 377 dhe 379 të Kodi Civil, në këndvështrimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe i vendimeve (dy) të Kolegjeve Civile të Gjykatës së Lartë

• Rubrika 7 – Aktivitete të Shkollës së Magjistraturës.

- **Tea Take, Ornella Troplini, Aurora Ndreu**  
**Mentore: Prof. dr. Arta Mandro**

- **Konkursi Themis 2025**, - Kufijtë ndarës: Sfidat juridiksionale në rastet e divorcit ku përfshihen qytetarët shqiptar që jetojnë në BE.

Po në muajin prill u publikua në bibliotekën digjitale tek faqja e shkollës Buletini nr.1, për vitin akademik 2025-2026, që ka si qëllim të saj përçimin nëpërmjet temave të programit të trajnimit vazhdues dhe në lexues akoma më të gjerë se auditori, përmbajtja e së cilës është:

- E drejta e pronës në fokusin e ligjit “Për kthimin dhe kompesimin e pronave” dhe në aspektin kushtetues.
- Kontrolli gjyqësor ndaj vendimeve të organeve të Qeverisjes të sistemit të drejtësisë.
- Rivlerësimi i masave shtrënguese të sigurimit personal.
- Verifikimet lidhur me përgjegjshmërinë e të pandehurit.
- Padia e vërtetimit të faktit juridik dhe e vërtetësisë së marrëdhënies juridike ose të një dokumenti.

Ju ftojme të vizitoni rregullisht faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës për informacion të përditësuar mbi programet dhe veprimtaritë tona.

Me respekt,

**Shkolla e Magjistraturës**

[www.magjistratura.edu.al](http://www.magjistratura.edu.al)

**E-mail:** [info@magjistratura.edu.al](mailto:info@magjistratura.edu.al)



## AGJENDA E MUAJI MAJ

### Kalendari i trajnimeve

<u>Maj 2026</u>			
<b>MODUL a.15 “ DËNIMI PENAL DHE ALTERNATIVAT E TIJ”</b>		Ekspertë: Florjan Kalaja Erjon Bani  Lehtësues: Rudi Laze	<u>4 maj 2026</u>
Dënimet në Kodin Penal, caktimi i dënimeve plotësuese. Problematika lidhur me aplikimin e dënimeve plotësuese dhe ekzekutimin e tyre në praktikë. Rehabilitimi, efektet e tij në raport me caktimin e dënimit sipas praktikës së Gjykatës së Lartë. Alternativat e dënimit me burgim në Kodin Penal. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, kryerja e një pune në interes publik, qëndrimi në shtëpi si alternativat më të aplikuara. Problematikat e konstatuara në praktikën gjyqësore dhe ndryshimet ligjore.			
Dënimi me burgim të përjetshëm, përputhja me standardet ndërkombëtare. Dënimi me burgim të përjetshëm në veprat penale të mbetura në tentativë; në veprat penale të kryera me ulje të ekuilibrit mendor. Dënimi me burgim të përjetshëm si dënim penal fiks në Kodin Penal. Mundësia e ndryshimit të dënimit me burg të përjetshëm sipas nenit 65 të Kodit Penal. Interpretimi i dispozitës dhe praktika gjyqësore lidhur me efektet e ndryshimit të dispozitës. Dënimi me burgim të përjetshëm si kusht për të mos proceduar me gjykimin e shkurtuar sipas nenit 403/2 të Kodit të Procedurës Penale.		Ekspertë: Genti Shala Flojera Davidhi  Lehtësues: Olti Skrame	<u>5 maj 2026</u>
<b>MODUL a.14 “MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME JASHTË”</b>		Ekspertë: Klodian Kurushi Amarildo Laçi Lehtësues: Florian Borici	<u>6 maj 2026</u>
Transferimi i personave të dënuar. Kushtet dhe procedura e transferimit. Zbatimi i nenit 11 të Konventës “Për transferimin e personave të dënuar”.			



<b>MODUL c.6 “SHQYRTIMI GJYQËSOR I AKTIT ADMINISTRATIV”</b>		Ekspertë: Nafije Hasko Elda Vrioni  Lehtësues: Etleva Gjamo	<u>7 maj 2026</u>
<p>Cilësia e hetimit gjyqësor në gjykatat e faktit. Si drejtohet një seancë gjyqësore efektive dhe e strukturuar? Roli I gjyqtarit administrative për një hetim gjyqësor efektiv. Menaxhimi i seancës, koha e gjykimit dhe organizimi efektiv i seancës, ndërhyrjet e gjyqtarit, ruajtja e autoritetit dhe neutralitetit. Drejtimi aktiv I seancës gjyqësore dhe roli i gjyqtarit në garantimin e kontradiktoritetit. Gjyqtari si garant i ligjshmërisë dhe barazisë procedural. Funksioni i veçantë institucional që ka gjyqtari administrative i shkallës së parë në raport me qytetarin dhe administratën publike. Roli dhe përgjegjësitë e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit kur vepron si gjykatë e shkallës së parë.</p>			
<p>Pushteti gjyqësor administrativ përballë administratës publike. Kufijtë e pushtetit të gjyqtarit administrativ. Ushtrimi nga gjyqtari administrativ i kontrollit të plotë të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, pa e zëvendësuar administratën. Vendosja e balancës midis efektivitetit të kontrollit gjyqësor dhe respektit ndaj diskrecionit administrative. Një qasje krahasuese mbi modelin gjyqësor të kontrollit të ekzekutivit në të drejtën evropiane.</p>		Ekspertë: Sokol Sadushi Erind Mërkuri  Lehtësues: Iva Çorri (Zemani)	<u>8 maj 2026</u>
<b>MODUL b.5 “KONTROLLI I AKTEVE TË ORGANEVE TË SHOQËRISË TREGTARE. NATYRA E VENDIMARRJES SË GJYKATËS”</b>		Ekspertë: Alma Hicka Alma Kodraliu  Lehtësues: Kostandina Kuro	<u>11 maj 2026</u>
<p>Padia për zgjidhjen e pasojave financiare në konfliktet gjyqësore midis administratorit dhe shoqërisë. Natyra e vendimmarrjes së organeve të shoqërisë në rastin e emërimit dhe shkarkimit të Administratorit nga</p>			



	<p>shoqëritë e kapitalit. Natyra e raportit mes shoqërisë dhe administratorit sipas LSHT-së. A është një marrëdhënie që rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës apo ato të LSHT-së. Natyra juridike e aktit të shkarkimit të administratorit dhe zgjidhja e pasojave që vijnë nga kontrolli i tij.</p>			
	<p><b>MODUL b.6 “PROVAT NË PROCESIN CIVIL”</b></p> <p>Provueshmëria në procesin gjyqësor: arsyetimi i provueshmërisë së fakteve ligjore në proceset penale dhe civile; standardet e provueshmërisë; relevanca, besueshmëria dhe forca bindëse e provës; probabiliteti dhe provueshmëria në procesin gjyqësor; analiza e provave në arsyetimin gjyqësor dhe praktika gjyqësore.</p>		<p>Ekspertë: Artur Kalaja Vojsava Osmanaj Kola</p> <p>Lehtësues: Anila Karanxha</p>	<p><u>12 maj 2026</u></p>
	<p>Provat me shkresë në procesin civil dhe autonomia private e palëve në procesin e të provuarit. Përdorshmëria e akteve procedurale dhe papërdorshmëria e provave në gjykimin civil dhe administrativ. Procesi i të provuarit në procesin civil.</p>		<p>Ekspertë: Sokol Pina Nurjeta Pogaçe</p> <p>Lehtësues: Megi Strakosha</p>	<p><u>13 maj 2026</u></p>
	<p><b>Trajnim 1 ditor</b> <b>Lidershipi në gjykatë dhe prokurori, thelbësor për funksionimin e drejtësisë në shoqëri. Ndikimi pozitiv për të promovuar vlerat e drejtësisë dhe barazisë.</b></p>		<p>Ekspertë: Arben Isaraj Ardian Dvorani</p> <p>Lehtësues: Hazbi Balliu</p>	<p><u>14 maj 2026</u></p>
	<p><b>MODUL a.15 “ DËNIMI PENAL DHE ALTERNATIVAT E TIJ”</b></p> <p>Përdorimi i gjysmëlirisë si alternativë e dënimit më burgim (neni 58). E drejta dhe jurisprudenca vendase dhe ndërkombëtare. Interpretimi dhe aspekte procedurale të gjysmëlirisë dhe nxitja e përdorimit të kësaj alternative. Standardet ndërkombëtare dhe aspekti krahasimor me vendet e tjera.</p>		<p>Ekspertë: <u>Kreshnik Ajazi</u> <u>Paulin Cera</u></p> <p>Lehtësues: <u>Ledion Tema</u></p>	<p><u>18 maj 2026</u></p>
	<p><b>Trajnim 2-ditor</b></p>	<p><u>Proje</u> <u>kti i</u> <u>Binja</u></p>	<p>Ekspertë Paola Filippi Olga Pirone</p>	<p><u>18-19 maj</u> <u>2026</u></p>



	<p>Trajnim mbi Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, veçanërisht duke u përqendruar në çështjet e pronësisë</p>	<p><u>këzim</u> <u>it</u></p> <p><u>Ekspe</u> <u>rt</u> <u>SHM</u></p>	<p>Marsida Xhaferllari</p>	
	<p><b>MODUL a.16 “DHUNA ME BAZË GJINORE”</b></p> <p>Aksesi i grave në drejtësi, të drejtat e grave, barazia gjinore, shmangia e stereotipizimit gjinor dhe përdorimi i metodave të marrjes në pyetje me ndjeshmëri gjinore. Legjislacioni vendas dhe standardet ndërkombëtare në fushën e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Detyrimet që burojnë nga Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) dhe Rekomandimet e Komitetit Grevio dhe CEDAË për sistemin e drejtësisë. Zbatimi i dispozitave të Konventës së Stambollit dhe interpretimi i dispozitave ligjore kombëtare nën frymën e saj dhe fushave specifike të saj. Roli i psikologut dhe punonjësit social në kuadrin e aksesit qytetar në organet e drejtësisë, si dhe për mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturve.</p>	<p><u>UND</u> <u>P</u></p>	<p>Ekspertë: Aurela Anastas Adelajda Gjuzi</p> <p>Lehtësues: Eliona Elezi</p>	<p><u>19 maj 2026</u></p>
	<p>Format e dhunës me bazë gjinore. Parashikimet ndërkombëtare dhe praktika e GJEDNJ-së. Masat ndaj dhunës me bazë gjinore. Zbatimi i masës mbi largimin menjëherë të dhunuesit nga banesa (Ligji 125/2020), për mbrojtjen e duhur të të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje e praktikave të dëmshme.</p>	<p><u>UND</u> <u>P</u></p>	<p>Ekspertë: Ornela Naqellari Diamela Goxha</p> <p>Lehtësues: Ervisa Hyka</p>	<p><u>20 maj 2026</u></p>
	<p><b>Trajnim 1 ditor</b></p> <p>Trajnim në lidhje me vendimet e gjykatës së lartë për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore (të cilat datojnë nga viti 2018 e në vijim), të grupuara këto trajnime për sa i përket llojit të çështjeve civile/penale/administrative. Pozita kushtetuese dhe ligjore e Gjykatës së Lartë si garant i unifikimit të jurisprudencës. Zbatimi i</p>	<p><u>ILD</u></p>	<p>Ekspertë: Arta Vorpsi Enton Dhimitri</p> <p>Lehtësues: Elton Frashëri</p>	<p><u>21 maj 2026</u></p>



	jurisprudencës së unifikuar dhe shmangia e saj përmes arsyetimit.			
	<b>Trajnim 1 ditor</b> Funksioni i Gjykatës Administrative të Apelit dhe i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në kontrollin e vlefshmërisë së akteve normative nënligjore. Roli i Gjykatës Administrative të Apelit si gjykatë kompetente për paditë kundër akteve normative sipas nenit 4/3 të ligjit nr. 49/2012, si dhe roli korrektues dhe unifikues i Gjykatës së Lartën ë rastet e praktikës kontradiktore lidhur me këtë lloj kontrolli. Kompetencat kushtetuese dhe ligjore, si pjesë e juridiksionit të tyre funksional. Mjetet procedurale përmes të cilave ushtrohet ky kontroll (padi e drejtpërdrejtë, kontrolli incidental).		Ekspertë: Sokol Sadushi Altina Nasufi  Lehtësues: Erind Mërkuri	<u>22 maj 2026</u>
	<b>MODUL c.6 “SHQYRTIMI GJYQËSOR I AKTIT ADMINISTRATIV”</b> Riti gjykimor pranë gjykatave administrative (shkalla e parë, apel, Gjykatë e Lartë). Problematika të praktikës gjyqësore në drejtim të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Administrative të Apelit.		Ekspertë: Selvie Gjoçaj Gentian Medja Lehtësues: Enisa Shahini	<u>25 maj 2026</u>
	<b>MODUL a.12 “PROVAT DHE MJETET E KËRKIMIT TË PROVËS NË PROCESIN PENAL”</b> Kontrolli i vendeve dhe personave. Kushtet për kryerjen e kontrollit. Dallimi midis kontrollit si mjet për kërkimin e provës dhe kontrollit si mjet për të marrë të dhëna lidhur ekzistencën e një fakti penal. Rëndësia e pasqyrimin në mënyrë të detajuar të faktit penal në raport me përcaktimin në mënyrë të detajuar të provave materiale që kërkohen me anë të kontrollit. Kontrolli në kushtet e flagrancës. Moszbatimi i kontrollit brenda afatit 72 orë nga vendimmarrja e gjykatës dhe efekti mbi ligjshmërinë e kontrollit. Sekuestrimi i sendeve gjatë kontrollit. E drejta për të pasur të pranishëm një person të besuar/mbrojtës gjatë kontrollit. Mënyra e		Ekspertë: Henrik Ligori Daniela Sulaj  Lehtësues: Ajkuna Anxhaku	<u>26 maj 2026</u>



dokumentimit të saj dhe pasojat e mosrespektimit të kësaj të drejte në vlefshmërinë e kontrollit. Kontrolli i banesës, kuptimi i “banesës” sipas praktikës gjyqësore, ligjshmëria e vendimit të kontrollit i cili është urdhëruar të kryhet tej afateve që parashikon neni 206 i Kodit të Procedurës Penale.			
<b>Trajnim 2- ditor</b> Drejtësia digjitale në Bashkimin Evropian. Koncepte dhe zhvillime rregullatorë.	<b>EIPA</b> <b>SHM</b>	Ekspert Ylli Pjetërnikaj	<u>26 maj 2026</u> <u>28 maj 2026</u>
Përgjimet procedurale dhe parandaluese. Kufijtë e lejimit të përgjimit. Regjistrimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave. Praktika gjyqësore.		Ekspertë: Sokol Binaj Klodian Braho  Lehtësues: Elsa Miha	<u>28 maj 2026</u>
<b>MODUL b.6 “PROVAT NË PROCESIN CIVIL”</b> Provat elektronike në procesin civil. Llojet e provave. Përdorshmëria dhe fuqia e tyre provuese. Trajtimi i provës elektronike sipas praktikës shqiptare dhe asaj ndërkombëtare.		Ekspertë: Dashmir Kore Flutura Kola  Lehtësues: Alda Sadiku	<u>29 maj 2026</u>